Imazhi është perceptimi që krijohet si rezultat i informacionit apo përvojave për një vend, individ, apo popull të caktuar. Perceptimi i krijuar mund të përfshijë stereotipe, paragjytime apo edhe perceptime pozitive ose negative. Ky studim synon që të paraqesë një tablo të qartë të shkaqeve të paragjykit të shqiptarëve dhe pasqyrimi e këtyre paragjykimeve në mediat britanike ndikuar edhe nga një figurë e rëndësishme politike sic është ish-ministrja britanike, Suella Braverman, me qëllim kuptimin e arsyes së krijimit të paragjykimeve negative dhe si mund të përmirësohet imazhi. Për të arritur këtë qëllim janë monitoruar dy nga mediat më të mëdha britanike siç janë “The Guardian” dhe “Daily Mail” për periudhën kohore nga viti 2022-2023, me lajmet që këto media kanë shkruar veçanërisht pas deklaratave të ish-ministres. Metodologjia përfshin: analizimin e lajmeve në përmbajtjen e tyre sa u takon paragjykimeve kundrejt shqiptarëve, monitorimin në kohë se kur janë postuar më shpesh lajme në këto media për këtë çështje, lloji i lajmit, ndikimin e mediave nga njëra-tjetra për lajme të ndryshme dhe ndikimin e lajmeve në krijimin e imazhit për shqiptarët. Përfundimet e këtij studimi tregojnë se imazhi për një komb apo popullin e tij mund të krijohet veçanërisht ndikuar nga aktorë të ndryshëm politikë. Në varësi të kësaj përfundimet sugjerojnë që çdo komb apo popull i tij duhet të përfaqësohet denjësisht dhe të vendosë në vendin e duhur identitetin e tij.

Fjalë kyç: diplomaci publike, diplomaci mediatike, imazh, media ndërkombëtare, aktorë politikë, stereotipe, paragjykim, “Daily Mail”, “The Guardian”

Ndikimi i pas së vërtetës (post-truth) te studentët

Gentiana Tosku

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: gentiana.tosku@universitetiaab.com

Abstrakt

Në kohën kur dezinformimi dhe fake news po përhapen përmes kanalave dixhitale me një ritëm të paprecedent, bëhet thelbësore nevoja e të kuptuarit se si studentët e shohin të vërtetën. Sfidat pas së vërtetës janë të dukshme në shkencë dhe jo vetëm, prandaj ky punim thellohet të hulumtojë qëndrimet dhe besimet e studentëve në epokën e pas së vërtetës. Punimi ka për qëllim që të kontribuojë në kuptimet teorike të perceptimit të së vërtetës në përgjithësi, e të vërtetës në epokën dixhitale në veçanti si dhe, të ofrojë njohuri praktike për studentët që përpiqen të kultivojnë qytetarinë e informuar në një epokë të bollëkut dhe paqartësisë së informacionit. Përmes intervistave dhe anketatave, ne mund ta shohim se në çfarë shkalle studentët e pranojnë konceptin *post-tuth*. Përmes këtij punimi do të analizohet mbështetja e studentëve në mediat sociale si burim parësor informacioni dhe kufijtë e paqartë midis faktit dhe opinionit. Për më tepër, në këtë punim do të shqyrtohet roli i edukimit në të menduarit kritik të studentëve dhe aftësive të tyre të formësimit në vlerësimin e së vërtetës.

Fjalë kyç: Post-truth, student, edukim mediatik, e vërteta.

Komunikimi i brendshëm në mediat 'Report TV' dhe Shqiptarja.com

Sibora Elezaj

Universiteti i Tiranës, Departamenti i Historisë dhe Filologjisë

Email: siboraelezaj1@gmail.com

Abstrakt

Ky studim trajton komunikimin e brendshëm të mediave 'Report Tv' dhe 'Shqiptarja.com'. Përmes këtij punimi synohet të sillët një panoramë e komunikimit të brendshëm në strukturat mediatike shqiptare, sa i rëndësishëm është komunikimi efektiv për të ardhmen e organizatave mediatike, teksa mbijetesa e tyre bëhet edhe më e vështirë përballë zhvillimit të mediave online. Për këtë arsye, në analizë është marrë një media tradicionale dhe zgjatimi i saj online, *Shqiptarja.com*. Punimi bazohet në qasjen e studimit cilësor. Janë zhilluar vizita në ambientet e *Report Tv*, intervista me kryeredaktoret e *Report Tv* dhe *Shqiptarja.com*, përgjegjësen e burimeve njerëzore dhe anketa me punonjësit. Punimi analizon strategjinë e komunikimit të brendshëm që ndjekin këto dy media, nga kanalet e komunikimit, mënyra e komunikimit mes drejtuesve dhe stafit, komunikimi mes departamenteve të ndryshme, trajnimi i stafit, roli i lidershit dhe sa rëndësi i kushtohet komunikimit organizativ.

Duke ekzaminuar strategji të ndryshme të komunikimit të brendshëm dhe ndikimin e tyre në angazhimin, kënaqësinë dhe produktivitetin e punonjësve, ky hulumtim kërkon të ofrojë njohuri të vlefshme për organizatat që përpiqen të optimizojnë praktikën e tyre të komunikimit të brendshëm.

Fjalë kyç: komunikimi i brendshëm, televizion, media online, komunikimi, organizata mediatike.

Shkelja e etikës në debatet televizive si mungesë e kulturës së debatit, apo si qëllim për rritjen e shikueshmërisë?

Nusret Shiti

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: nusret.shiti@universitetiaab.com

Abstrakt

Në epokën e sotme të shumësisë së mediave ku gjithkush flet për gjithçka, ndodh shpesh që diskutuesit publikë përveçse flasin për gjërat që kanë njohuri sipërfaqësore, gjithashtu nuk respektojnë as parimet etike. Vendet e diskutimit që kanë më shumë vëmendje të publikut, janë diskutimet e realizuara në televizion. Ajo që bie në sy në këto diskutime publike është se pjesëmarrësit nuk janë në nivelin e duhur profesional për çështjen që flasin, por gjithashtu edhe të shfaqjes së një lloj arrogance kundrejt tjetrit. Në këtë punim dua të sjell disa parime etike të diskutimit në televizion. Punimi do të analizojë këto debate televizive duke u nisur që nga organizatori i debatit - moderatori, pjesëmarrësit në debat, gjuha e përdorur dhe specifikat përgjatë këtij diskutimi. Qëllimi i këtij punimi është të identifikojë këto lëshime, për të shërbyer për vetëdijesimin e debatuesve publikë se si duhet të ballafaqohen me mendimin e tjetrit dhe për t'i vetëdijësuar për një tolerancë më të madhe për mendimin ndryshe, apo siç thuhet, "ai që nuk mendon si ti, nuk është armiku yt". Pra, nëpërmjet një analize kritike të përmbajtjes, punimi konkludon se në shumë debate televizive shkelen normat etike nga mungesa e një kulture debati, por ndonjëherë edhe qëllimisht, për efekt shikueshmërie.

Fjalë kyç: debat, etikë, televizion, shikueshmëri.

Gjuha e urrejtjes në mediat sociale: pasojat dhe zgjidhjet e mundshme

Artan Haraqia

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: artan.haraqia@universitetiaab.com

Abstrakt

Rritja e mundësive të komunikimit, marrja dhe shpërndarja e shpejtë e informacionit si dhe rritja apo plotësimi i dijes individuale e shoqërore, janë disa prej elementeve pozitive që kanë sjellur në shoqërinë tonë mediat sociale. Por, në të njejtën kohë, mediat sociale u kanë dhënë të drejtën e fjalës legjioneve të idiotëve... (Eco 2015). Toni i bisedës në internet është bërë dukshëm më agresiv vitet e fundit pasi platformat e mediave sociale janë shfaqur si një hapësirë në të cilën lulëzon armiqësia dhe gjuha e urrejtjes (Mondal, 2017). Në mesin e efekteve negative, gjuha e urrejtjes mbetet ndër më shqetësueset edhe në Kosovë. Prandaj, qëllimi i kryesor i këtij punimi është që përmes analizës së përmbajtjes së komenteve të verifikojë dhe të analizojë disa prej rasteve të përditshme të shfaqjes së gjuhës së urrejtjes në mediat sociale, me theks të veçantë në rrjetin social Facebook, si rrjeti më i përdorur në vendin tonë; të ndajë ato sipas temave dhe të tentojë të identifikojë nxitësit dhe ndjekësit. Në fokus të këtij punimi është vënë edhe trajtimi ligjor e shoqëror që i bëhet kësaj dukurie. Pa pretenduar që të japë zgjidhje përfundimtare, punimi synon gjithashtu të përmendë disa shembuj konkretë dhe disa mundësi, të paktën, për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së gjuhës së urrejtjes në mediat sociale.

Paralajmërim: Ky punim përmban shembuj me fjalë fyese dhe të gjuhës së urrejtjes.

Fjalë kyç: gjuhë e urrejtjes, mediat sociale, internet, nxitje.

Stereotipizimi i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në jetën e përditshme

Nora Gjuzi

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: nora.gjuzi@universitetiaab.com

Abstrakt

Stereotipizimi i komunitetit rom në jetën e përditshme nuk është thjesht një fenomen i cili prek aspektin e tyre social, por edhe një pengesë e integritetit të këtij komuniteti në shoqërinë kosovare. Ky komunitet shpesh identifikohet me term pejorativ dhe gjuhë përçmuese të tipit: jeni bërë si “magjup”. Termi “magjup” shpesh përdoret për t’iu referuar komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Komuniteti “RAE”, është termi i cili më së shumti përdoret në media me ose pa dashje dhe kështu media ka ndikuar në forcimin e këtij koncepti për këto tre komunitete. Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të shqyrtojë dhe të analizojë mënyrën se si mediat paraqesin dhe formësojnë koncepte të reja mbi identitetin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë kuadër shtrohet pyetja se si mediat mund të ndikojë në perceptimin e këtyre komuniteteve, duke qenë se këto komunitete në media paraqiten shpesh vetëm për jetën e tyre të vështirë socio-ekonomike, për mosshkollimin e tyre, martesat e hershme, braktisjen e shkollimit etj. Metoda e përdorur në këtë punim është kryesisht analizë e përmbajtjes së raporteve mediatike dhe diskursit publik ndaj grupeve të marginalizuara. Punimi konstaton se mediat kanë përgjegjësi dhe duhet të përmbahen nga publikimi i mesazheve diskriminuese që cenojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, duke mos raportuar me paragjykime dhe duke mos stereotipizuar edhe më tej komunitetet në shoqërinë kosovare.

Fjalë kyç: Stereotipizim, media, rom, ashkali, egjiptian.

Fact-checking në epokën e mediave sociale

Edon Gërbani

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: edon.gerbani@universitetiaab.com

Abstrakt

Në kohën moderne, e njohur si epoka digjitale e mediave sociale, "fact-checking" (verifikimi i fakteve) është bërë një mjet kyç në luftën kundër dezinformatave dhe lajmeve të rreme. Ndaj ky punim synon të shpjegojë dhe të analizojë rolin e verifikuesve të fakteve në epokën tonë. Punimi fillimisht do të ofrojë një analizë të literaturës dhe studimeve të rasteve specifike nga rajoni, bota dhe Kosova, ndërsa pyetja kërkimore që shtrihet është se si fakt-checker-ët mund të përmirësojnë efektivitetin e tyre dhe të kontribuojnë në një diskurs më të shëndetshëm publik. Metodatat e përdorura në këtë studim përfshijnë analizat sasiore, nëpërmjet përdorimit të statistikave dhe të dhënave për të analizuar raste konkrete të lajmeve të rreme dhe për të matur ndikimin dhe efektivitetin e verifikimit të fakteve. Rezultatet tregojnë se, ndonëse gazetaria hulumtuese përfshin elemente të kontrollimit të fakteve, këto disiplina mbeten të ndara. Përfundimet theksojnë nevojën për praktika të përmirësuara dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik, edukimin mediatik, përgatitje të faktuesve të ardhshëm dhe për rëndësinë e verifikimit të fakteve në epokën digjitale.

Fjalë kyçe: rrjete sociale, fact-checking, dezinformata, media online, inteligjencë artificiale.

Mediat sociale si mjet për përfaqësimin dhe ndërtimi e identitetit personal në epokën dixhitale

Amela Rama

Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, FHF, Universiteti i Tiranës

Email: amelarama2000@gmail.com

Abstrakt

Ky studim shqyrton rolin e mediave sociale si një platformë për përfaqësimin dhe ndërtimin e identitetit personal në kontekstin e epokës dixhitale. Përmes një analize të literaturës dhe intervistave me përdorues të rrjeteve sociale, kërkohet të kuptohet si individët shfrytëzojnë këto platforma për të shprehur vetveten dhe për të krijuar një imazh të tyre në publik. Përqendrohet në mënyrat në të cilat përdoruesit përdorin strategji të ndryshme për të prezantuar identitetin e tyre në një formë autentike dhe efektive. Përtej kësaj, studimi analizon edhe ndikimin e rrjeteve sociale në ndërtimin e bashkësisë dhe në formimin e lidhjeve sociale.

Kërkohet të kuptohet si individët shfrytëzojnë rrjetet sociale për të treguar më shumë nga vetja dhe për të ndërtuar një imazh të dëshiruar në publik. Një tjetër faktor kryesor i përdorur është pa dyshim marketingu personal për të rritur ndjekësit dhe për të ndikuar në perceptimin e tyre. Një marketing i mirë do të sillte më shumë pëlqyeshmëri nga audienca e synuar. Gjithashtu, do të analizohet roli i transparencës, konsistencës dhe autenticitetit në menaxhimin e imazhit personal online. Përtej kësaj, studimi identifikon sfidat dhe rreziqet e përfshira në prezantimin e vetes në një hapësirë të hapur dhe të publikut ku paragjykimi nuk mund të mungojë.

Në përfundim, ofron rekomandime për individët që dëshirojnë të përdorin rrjetet sociale në mënyrë të efektshme për të ndërtuar një brend personal të suksesshëm dhe të qëndrueshëm në kohën e mediave sociale.

Fjalë kyç: media sociale, imazh personal, ndikim social, paragjykim, identitet, transparencë, epokë dixhitale.

Analizimi i komunikimit të brendshëm të kompanisë së telekomunikacionit Vodafon

Suada Pirro

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Email: suadapirro01@gmail.com

Abstrakti

Ky studim shqyrton rolin dhe rëndësinë e komunikimit të brendshëm të kompanisë së telekomunikacionit *Vodafon Albania*. Përmes një hulumtimi të hollësishëm dhe përfaqësues empirike, ky studim ka si qëllim të ofrojë një kornizë të dinamikave të komunikimit të brendshëm të kësaj kompanie, rolin dhe efektivitetin e komunikimit mbi punonjësit e Vodafon, veçanërisht në kontekstin si agjentë të marrëdhënieve publike (PR) në publikun e gjërë. Metodologjia e këtij kërkimi përfshin një studim të gjërë përmes intervistave dhe anketimit me punonjës të ndryshëm, në pozicione të ndryshme. Kjo analizë paraqet një pasqyrë të qartë të lidhjes mes komunikimit të brendshëm dhe performacës së punonjësve, duke sugjeruar rekomandime për të përmirësuar strategjitë e komunikimit të brendshëm në Vodafone Albania dhe për të rritur ndikimin e punonjësve si 'ambasadorë' të markës në publik.

Fjalë kyç: Vodafon, agjentë të PR, komunikim i brendshëm, kulturë organizative.

Strategjia e komunikimit digjital të Bashkivë në Shqipëri

Olta Jahaj

Universiteti i Tiranës, FHF

Email: jahajolta@gmail.com

Abstrakt

Në një epokë të dominimit të teknologjisë, komunikimi digjital është bërë një komponent kyç për administratat publike, përfshirë bashkitë shqiptare. Ky studim synon të eksplorojë dhe analizojë strategjitë e komunikimit digjital të përdorura nga bashkitë në Shqipëri, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe angazhimit të qytetarëve. Për të arritur këtë qëllim, janë monitoruar dhe analizuar faqet zyrtare të internetit dhe platformat e rrjeteve sociale të bashkive Shkodër dhe Pukë. Metodologjia përfshin analizimin e përmbajtjes, frekuencës së postimeve, llojin e postimeve, ngjashmërinë e mesazhit në rrjete të ndryshme dhe ndërveprimet me qytetarët. Përfundimet e këtij studimi sugjerojnë se për të arritur një nivel më të lartë të efikasitetit në komunikim, bashkitë duhet të zhvillojnë strategji më të strukturuar për secilin rrjet social në vete që informacioni të mos jetë i njëjtë, sepse secili rrjet social ka veçantinë e tij dhe të investojnë në trajnimin e stafit për përdorimin efektiv të mjeteve digjitale.

Fjalë kyç: komunikim digjital, bashki, angazhim, rrjete sociale

Spektolarizimi mediatik i një drame familjare. Rasti i Elias dhe Princ Lekës

Artemisa Rreshka

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Email: artemisarreshka24@gmail.com

Abstrakt

Ky studim shqyrton ndërlikimet e dramës familjare shumë të diskutuar mes Princit Leka dhe ish-bashkëshortes së tij Elia, duke synuar të përcaktojë nëse ngjarjet ishin orkestruar kryesisht për qëllime të marrëdhënieve me publikun (PR). Nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse të faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë dëshmitë e motivimeve të PR, autenticitetin e emocioneve të shfaqura, mbulimin mediatik dhe reagimin publik, shpjegimet alternative, ky hulumtim kërkon të zbulojë dinamikën themelore të këtyre strategjive. Së pari, hulumtimi shqyrton çdo provë të prekshme që sugjeron manipulim strategjik të narrativës për përfitime të PR. Për më tepër, studimi vlerëson autenticitetin e emocioneve të portretizuara gjatë dramës, duke vlerësuar nëse ato duken të vërteta apo të sajuara. Më pas, duke analizuar mbulimin mediatik dhe reagimet publike, hulumtimi mat shkallën në të cilën ngjarjet tërhoqën vëmendjen e publikut dhe ndikuan potencialisht në perceptimin publik të individëve të përfshirë. Janë marrë në konsideratë efektet në reputacionin dhe imazhet publike të Princit Leka dhe Elias, duke ofruar njohuri për ndikimin e ashtuaquajtur 'dramë'. Së fundi, eksplorohe shpjegime alternative për ngjarjet, duke vlerësuar konfliktet personale, mosmarrëveshjet ligjore dhe faktorë të tjerë potencialë kundër hipotezës së PR. Duke sintetizuar këta elementë të ndryshëm, ky studim synon të ofrojë një kuptim të nuancuar të ndërveprimit kompleks midis dinamikës personale dhe strategjive të PR në kontekstin e dramave familjare të profilit të lartë.

Fjalë kyç: PR, strategji të PR, mbulim mediatik, princi Leka, Elia.

Strategjitë për krijimin e brandit turistik rasti i Shqipërisë

Angjelina Shahini

Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë

Email: angelinashahini388@gmail.com

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtohen strategjitë për krijimin e brandit turistik të një vendi. Në destinacionet turistike, brendi (marka) dallon nga imazhi i vendit, ndërsa imazhi i ndihmon njerëzit të dallojnë ndikimet që ato kanë si perceptime pozitive dhe negative për një vend të caktuar. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë se si ndikojnë lajmet për Shqipërinë në mediat e huaja dhe publikët e huaj. Nëpërmjet analizës së përmbajtjes se çfarë kanë raportuar mediat e huaja, ne kërkojmë të konstatojmë për imazhin e Shqipërisë në mendjen e publikëve të huaj. Punimi gjithashtu konstaton se Shqipëria është një vend i vogël dhe me resurse të kufizuara për të krijuar vetë një imazh të mirë dhe të fuqishëm si destinacion turistik, por kjo arrihet falë bukurive natyrore që ka për të cilat raportojnë gjithnjë e më shumë mediat e huaja dhe që e vendosin Shqipërinë si një destinacion turistik që vlen për t'u vizituar.

Fjalë kyç: Destinacion turistik, markë turistike, imazh, Shqipëria.

Raportimi i mediave të huaja për emigrantët shqiptarë

Anisa Gjutaj

Universiteti i Tiranës

Email: anisagjutaj@gmail.com

Abstrakt

Emigrimi i shumtë i shqiptarëve drejt vendeve të Europës ka bërë që të marrë vëmendjen e shume medive ndërkombëtare. Mediat si: The Sun, The Guardian, BBC, Daily Mail, The Times, kanë shkruar dhe vazhdojnë të shkruajnë për aktivitet e emigrantëve shqiptarë në vendin pritës. Ndodh shpesh që këto media të shkruajnë dhe bëjnë raportime mbi shqiptarët të cilët i përshkruanin si kriminelë dhe trafikantë, të cilët krijojnë një imazh negativ për vendin. Këto raportime dëmtojnë imazhin ndërkombëtar të vendit. Qëllimi i kësaj teme është të analizojë disa nga mediat ndërkombëtare për emigrimin e paligjshëm të shqiptarëve dhe veprimeve të tyre në vendin ku kanë emigruar. Në këtë studim shtrojmë pyetjen se sa ndikojnë mediat ndërkombëtare në imazhin e një vendi në këtë rast mbi imazhin e shqiptarëve. Ky punim konstaton se disa media ndërkombëtare raportojnë për shqiptarët si kriminelë dhe trafikant drogash dhe si një ndër vendet që kërkon më së shumti azil, si vend ku të rinjtë kërkojnë të ikin nga vendi i tyre si i pasigurt për jetesë. Të gjitha këto ndikojnë në imazhin ndërkombëtar të Shqipërisë.

Fjalë kyç: imazh ndërkombëtar, emigrantë të paligjshëm, lëndë narkotike, media ndërkombëtare.

Analiza e përmbajtjeve muzikore në portalet online të Kosovës

Arian Agushi

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: arian.agushi@universitetiaab.com

Abstrakt

Ky studim analizon llojin dhe cilësinë e përmbajtjeve muzikore të publikuara në portalet online të Kosovës dhe ndikimin e tyre në preferencat muzikore të audiencës. Duke përdorur analiza sasiore dhe cilësore, përfshirë intervista me profesionistë të industrisë muzikore dhe anketime të audiencës, studimi shqyrton se si këto përmbajtje formësojnë shijet muzikore të publikut. Një fokus i veçantë i hulumtimit është shqyrtimi i standardeve etike në raportimin dhe promovimin e muzikës, duke adresuar sfidat dhe dilemat etike si të drejtat e autorit dhe përdorimin e informacioneve të paautorizuara. Studimi analizon raste konkrete të praktikave sensacionale në mediat sociale dhe përhapjen e lajmeve të rreme për këngëtarët kosovarë. Përfundimet theksojnë rëndësinë e verifikimit të fakteve dhe ofrojnë rekomandime për përmirësimin e praktikave gazetareske dhe rritjen e parimeve etike në media, duke synuar një mjedis mediatik më të drejtë dhe të përgjegjshëm në Kosovë.

Fjalë kyç: media, muzika në media, portale online, analizë përmbajtjesh, etika gazetareske.

Imazhi i shqiptarëve nga pasqyrimi i mediave angleze

Miada Pçiri

Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë

Email: pcirmiada@gmail.com

Abstrakt

Në kushtet e një bote të mediatizuar, zhvillimit të shoqërive moderne mediatike imazhi i një vendi po bëhet më i rëndësishëm dhe më primar se kurrë më parë. Në këtë punim do të trajtohet pikërisht rëndësia e imazhit të një vendi si pjesë e rëndësishme e diplomacisë publike. Qëllimi i këtij punimi është të kuptohet dhe të shpjegohet se si ka ndikuar në imazhin e Shqipërisë mbulimi dhe raportimi nga mediat angleze për shqiptarët që jetojnë në Angli. Në këtë kuadër shtrohet pyetja se si mund të ndikojë ky mbulim mediatik në imazhin ndërkombëtar të Shqipërisë? Në këtë punim do të analizohet përmbajtja e disa mediave angleze që kanë raportuar mbi veprimtaritë e shqiptarëve që jetojnë në Angli. Në këtë kuadër janë përzgjedhur disa nga mediat kryesore angleze si: Daily Mail, The Sun dhe The Telegraph.

Gjetjet tregojnë se këto media kanë patur një mbulim relativisht të lartë mediatik ku në të shumtën e rasteve ka një pasqyrim negativ për shqiptarët që jetojnë atje. Sigurisht që këto raportime ndikojnë negativisht edhe për imazhin ndërkombëtar të Shqipërisë duke marrë parasysh ndikimin e mediave angleze në botë.

Fjalë kyç: imazhi ndërkombëtar i vendit, shqiptar, Shqipëri, Daily Mail, The Sun, The Telegraph

Dilema e reputacionit gjuhësor: analizë e filmit "Hancock" nga perspektiva e foljeve frazeologjike

Gresa Shaqiri

Kolegji AAB, Prishtinë

gresa.shaqiri@universitetiaab.com

Abstrakt

Përdorimi dhe reputacioni gjuhësor i foljeve frazeologjike të gjuhës angleze janë debatuar prej kohësh nga gjuhëtarët. Debati ushqehet edhe më tej kur këto struktura të kombinuara gjuhësore, folje dhe ndajfolje apo parafjalë, përdoren nga folësit e anglishtes që nuk e kanë gjuhë amtare, për dhënien e mesazhit, por pa vrarë mendjen për saktësinë gramatikore. Gjuhësisht, foljet frazeologjike njihen si karakteristika të të folurit të gjuhës angleze dhe shërbejnë për të bërë dallimin midis ligjërimit libror dhe atij bisedor. Bazuar në reputacionin jo aq të pranueshëm të tyre në ligjërimit libror, gjegjësisht në të folur dhe të shkruar, ky studim analizon gjuhën angleze të përdorur në filmin "Hancock", film i cili është sintezë e mjediseve të shumta ku integrohen diskurse personale, politike dhe institucionale. Prandaj qëllimi i këtij studimi është të analizojë teorinë se përdorimi i shpeshtë i foljeve frazeologjike në filma ekziston vetëm në ligjërimit bisedor dhe diskursin personal, por asnjëherë në diskursin politik dhe atë institucional. Të dhënat e tabeluara tregojnë se këto struktura gjuhësore përdoren dukshëm dhe ekzkluzivisht "në çdo dy fjali" në anglishtën e ligjërimit bisedor dhe në diskursin personal, ku numerikisht janë identifikuar 109 folje frazeologjike. Rezultatet theksojnë që foljet frazeologjike janë "mjete leksikore" që përcaktojnë diskurset dhe ligjërimet. Studimi konkludon se karakteristikat semantike të foljeve frazeologjike në filmin "Hancock" varen vetëm nga ndërtimi sintaksor.

Fjalë kyç: reputacion gjuhësor, folje frazeologjike, ligjërim libror, ligjërim bisedor, kontekst.

Pikëpamja nga publiku: Kur publiku dëshiron banalitetin

Alisa Bekteshi

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: alisa.bekteshi@universitetiaab.com

Abstrakt

Në një hapësirë shumë të zhvilluar mediatike në të cilën po jetojmë, publikut po i ofrohet mundësia e marrjes dhe shpërndarjes së informacionit në mënyrë shumë të shpejtë. Ky informacion jo gjithmonë është i bazuar në kode etike, morale dhe profesionale dhe shumë shpesh kur ajo audiencë identifikon këto informacione, disa janë vlera dhe disa antivlera të cilat mund t'i quajmë edhe banalitet. Njohja e vërtetë e vlerave ekzistuese dhe kontigjente të lajmeve, të shpien drejt “kthesës afektive” që kërkon media dhe konceptimi i po asaj që qasjen nga mediat ta kthejë në një ndjenjë të mirë që të shpërqendron (Perry Parks, 2021). Ky shpërqendrim është ajo çka po kërkon publiku. Andaj edhe qëllimi i këtij punimi është që përmes analizës së programit të identifikojë këto përmbajtje banale dhe të pasqyrojë arsyet se pse këto përmbajtje janë më të kërkuarat nga publiku. Punimi synon që përmes dallimit të këtij lloji të përmbajtjes, të ketë ndikim në demaskimin dhe heqjen e kompleksit kolektiv në përmbajtjet jo të duhura, të cilat konsiderohen dhe janë antivlera të shprehura në forma të ndryshme nga audienca.

Fjalë kyç: media, audienca, banaliteti, etika, përmbajtja

Fake news në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19

Drilonë Uruqi

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: drilone2.uruqi@universitetiaab.com

Abstrakt

Përhapja e lajmeve të rrema ka njohur një shtrirje të madhe gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Kjo ka bartur me vete shumë pasoja jo vetëm psikologjike e shëndetësore, por edhe sociale për shumë njerëz në mbarë botën. Shumë studiues konstatojnë se pasiguria dhe frika nga e ardhmja ka bërë që njerëzit t'u besojnë informacioneve gjysëm të vërteta apo aspak të vërteta. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është që përmes studimit dhe analizimit të sjellë disa raste konkrete të shpërndarjes së lajmeve të rreme gjatë kësaj periudhe. Punimi synon të sjellë para lexuesve faktin se si pasiguria sociale dhe psikologjike ka tendencë të drejtojë njerëzit në orientime të gabuara. Metodat e përdorura në këtë punim përfshijnë metodat kualitative që përmes analizimeve të raporteve të ndryshme veçmas atë të Reuters, të pasqyrojnë një situatë të detajuar për fake news gjatë pandemisë. Në përfundim të punimit jepen edhe rekomandime që theks të veçantë i vendosin edukimit mediatik.

Fjalë kyç: Fake nws, raport, Covid-19, media sociale, media online.

Marrja e informacionit nga vendet më të zhvilluara dhe ato me zhvillim më të ulët në online apo offline

Shaqir Shaqiri

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: shaqir.shaqiri@universitetiaab.com

Abstrakt

Kjo temë ka për synim të ofrojë një pasqyrë lidhur më atë se si shoqëritë e vendeve të zhvilluara dhe të atyre më pak të zhvilluara i marrin informacionet online apo offline. Njerëzit sot janë të barabartë për të arritur tek informacioni nëpërmjet rrjetizimit të internetit, ku si rezultat sot çdo individ është i barabartë në dhënien dhe marrjen e informacionit. Përhapja e madhe e internetit si dhe familjarizimi me të e ka bërë më të lehtë komunikimin nëpërmjet platformave të ndryshme të rrjetizimit, por që mbetet të shihet se nga është orientimi i shoqërisë. Qëllimi punimit është të krahasojë marrjen e informacionit nga online dhe offline sipas hulumtimit të realizuar në nivel global nga Reuters Institute e Oxfordit. Kurse, pytja kryesore kërkimore është se nga informohen vendet më të zhvilluara dhe ato më pak të zhvilluara? Ky punim konkludon se si vendet e zhvilluara perëndimore vazhdojnë të marrin informacionin më shumë nga offline, ndërsa ato me zhvillim më të ulët janë më shumë online. Ndërsa, japonezët dhe tajvanezët janë mjaft të profilizuar sipas industrisë dhe jo kanaleve të komunikimit.

Fjalë kyç: Rrjetizim, informacion, media sociale, televizion, online, offline.

Gazetaria investigative si një e mirë publike: Rasti i Shqipërisë

Oneda Bukaçi

Gazetari dhe komunikim, Universiteti i Tiranës

Email: onedabukaci@gmail.com

Abstrakt

Tradicionalisht, detyra kryesore gazetarëve në shoqëritë demokratike është mbrojtja e interesit publik përmes informacionit, i cili është në vetvete një e mirë publike. Gazetaria investigative është një ndër format klasike të të ekspozuarit të problematikave që lidhen me çënimin e interesit publik. Nën shembullin e mediave perëndimore, edhe në Shqipëri zhvillimet më të rëndësishme të këtij zhanri, u vërejtën pas shembjes së komunizmit. Aktualisht, në vend ka një numër të madh emisionesh investigative si edhe mini redaksish që punojnë në këtë drejtim, megjithatë nuk ka ende një studim të mirëfilltë që të mund të pasqyrojë ndikimin e tyre në luftën ndaj të gjitha formave të korrupsionit, shkeljeve ligjore dhe mbi të gjitha, në shërbim të interesit publik. Qëllimi i këtij studimi qëndron në rëndësinë e gazetarit investigativ, ndërsa pyetja është se si operohet për të zbardhur në mënyrë sistematike dhe etike një padrejtësi për t'i treguar botës se çfarë po ndodh në të vërtetë. Në këtë punim do të analizohen aspekte të gazetarisë investigative gjatë dekadës së fundit në Shqipëri, problematikat dhe sfidat e saj. Punimi do të zhvillohet duke u bazuar në metodën cilësore për të analizuar kriteret dhe domosdoshmeritë e kësaj lloji gazetarie, duke diskutuar dhe analizuar punën dhe metodat e përdorura nga gazetarët hulumtues. Gjithashtu, falë një sondazhi online do të kërkohet se si vlerësohet gazetaria investigative që ofrohet në Shqipëri. Studimi do të bazohet në investigime konkrete të realizuara nga "Qendra për gazetari cilësore", në Shqipëri e mbështetur nga Ambasada Amerikane.

Fjalë kyç: gazetari investigative, interes publik, Shqipëri.

Përdorimi i mediave sociale për informim

Shyhrete Maloku

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: shyhrete3.maloku@universitetiaab.com

Abstrakt

Ky punim flet për përdorimin e mediave sociale si burim informacioni, duke analizuar anët pozitive dhe negative të kësaj praktike. Mediat sociale ofrojnë shpejtësi dhe kohë reale të shpërndarjes së informacionit, duke lejuar përdoruesit të qëndrojnë të informuar në çast. Përveç kësaj, ato ofrojnë një platformë për ndarjen e opinionëve dhe për të marrë pjesë në diskutime publike, duke forcuar pjesëmarrjen qytetare dhe demokratike. Megjithatë, përdorimi i mediave sociale për informim paraqet edhe sfida të konsiderueshme. Mungesa e verifikimit të fakteve dhe përhapja e dezinformatave dhe lajmeve të rreme janë disa nga problemet kryesore. Sipas raportit të Reuters Institute për Studimin e Gazetarisë (2023), shumë përdorues janë të shqetësuar për dallimin midis informacionit të vërtetë dhe atij të rremë, veçanërisht në rrjetet sociale të reja si TikTok dhe Instagram, ku influencerët dhe personalitetet shpesh marrin më shumë vëmendje sesa gazetarët. Punimi do të mbështetet në literaturë që trajton këtë fenomen dhe do të analizojë raste konkrete. Do të shqyrtohen rekomandimet për përdoruesit e mediave sociale që të jenë më të kujdesshëm dhe të informuar në mënyrë kritike. Përfundimisht, do të theksohet rëndësia e edukimit mediatik për të përmirësuar aftësitë e përdoruesve në identifikimin e burimeve të besueshme dhe shmangien e dezinformatave, duke marrë parasysh ndryshimet e vazhdueshme në shumëllojshmërinë e platformave dixhitale.

Fjalë kyç: media sociale, informim, dezinformim, fake news, edukim mediatik, Reuters.

Ndikimi i kulturës shqiptare te perceptimi i të huajve

Thëllënza Ramaj

Universiteti i Tiranës, FHF

Email: thellenzaramaj@gmail.com

Abstrakt

Shqipëria është një vend me tradita dhe kultur shumë diverse dhe kjo vihet re nga të huajt që vizitojnë Shqipërinë. Shqiptarët janë të dashur dhe mjaft të hapur ndaj të huajve që vizitojnë vendin e tyre. Për promovimin e çdo tradite shqiptare ndikimin më të madh e ka media. Në këtë studim kam paraqitur jo vetëm kulturën shqiptare bashkë me të gjitha komponentet që e karakterizojnë, por edhe ndikimin që ka ajo te vizitorët e huaj. Ndërsa janë duke fituar terren traditat e reja të sjelljes, mund të thuhet që edhe ato tradicionale respektohen gjerësisht në shumë vise madje edhe nga të rinjtë. Media ka ndikuar në ruajtjen dhe kalimin e ktyre traditave nga brezi në brez. Elementët që po marrin shumë zë janë mikëpritja, bujaria toleranca fetare, veshjet tradicionale që janë shumë të larmishme, gjuha bashkë me dy dialektet e saj, kanuni, muzika tradicionale si dhe vallet popullore. Punimi konstaton se të gjitha këto së bashku na lartësojnë ne si popull duke na i dhënë vlerat që i meritojmë. Gjithashku ndikojnë pozitivisht në rritjen e ekonomisë dhe turizmit. Prandaj ky punim rekomandon që këto vlera të vendit (soft power) duhet promovuar ndërkombëtarisht, sepse rrisin imazhin e Shqipërisë.

Fjalë kyç: Shqipëria, tradita, kulturë, vizitorë, media.

Populizmi në mediat sociale

Bernard Zeka

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: bernard.zeka@universitetiaab.com

Abstrakt

Sipas një koncepti minimal, populizmi përkufizohet si një ideologji “thin-centred”, e cila bazohet jo vetëm në dallimin “emocional” midis “popullit të pastër” dhe “elitës së korruptuar”, por edhe në mbrojtjen e sovranitetit popullor me çdo kusht. (Oxford Handbooks of Ideologies 2013). Populizmi ka ekzistuar në diskursin politik qysh në kohët e hershme, megjithatë, mundësitë e vogla të shpërndarjes fizike dhe “gatekeeping-u” i mediave nuk ka lejuar që kjo dukuri të marrë përmasa të mëdha. Aktualisht, populizmi po shënon rritje çdo vit e më tepër dhe kjo falë botës online në të cilën po jetojmë, konkretisht rrjeteve sociale, të cilat janë shëndruar në një platformë ideale për politikanët populistë. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është që përmes analizës së përmbajtjeve, të sjellë dhe të analizojë shembuj konkret të populizmit në Kosovë, përmes rrjeteve sociale, saktësisht në rrjetin social Facebook, si platforma më e përdorur në komunikimin politik lokal. Punimi do të provojë të nxjerrë në dritë nëse klasa politike në Kosovë ka tentuar që ta përdor populizmin si mjet manipulativ për marrje apo mbajtje të pushtetit.

Fjalë kyç: populizmi, rrjete sociale, politika populiste, manipulimi.

Specifikat dalluese të bulizmit online nga ai tradicional

Besë Murseli

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: bese.murseli@universitetiaab.com

Abstrakt

Në përgjithësi bulizmi është një fenomen me ndikim negativ në shoqëri, qoftë në anën psikologjike ashtu edhe atë fizike. Por, kur bulizmi rrjedh papengueshëm përmes mediave sociale, atëherë efektet e tij negative janë pothuasje të pakontrollueshme. Qëllimi i këtij punimi është që të bëjë krahasime ndërmjet shtrirjes që ka një ngacmim offline në jetën e përditshme – me ngacmimin online që ka një shtrirje shumë herë më të madhe dhe efekte më të mëdha, me fokus të veçantë te moshat e reja. Përmes analizës së aktorëve të komunikimit dhe asaj të përmajtjes, punimi sjell disa raste konkrete të bulizmit online. Rezultatet tregojnë se një ngacmim në mjedise offline, në shkollë apo mjedise shoqërore, personat të cilët janë publik në këtë akt ngacmimi, mund të jenë disa dhjetëra. Ndërkaq, nëse një person bulizohet në mediat sociale, personi i bulizuar i ekspozohet një publiku shumë herë më të gjerë, për shkak se publiku online edhe mund të shumëfishohet si rezultat i mundësisë së shpërndarjes së mesazheve bilizuese në mediat sociale. Gjithashtu, personat që mund t'i bashkohen një ngacmimi online mund të jenë në numër shumë herë më të madh sesa ata offline. Punimi përfundon me rekomandime se duke ringritur këto shqetësime, të ndikojë sadopak në vetëdijësimin e përgjithshëm për efektet dhe dëmin e bulizmit online si fenomen më i dëmshëm se ai tradicional, offline.

Fjalë kyç: bullizëm, bulizëm online, media sociale, efekte negative.

Impakti i rrjeteve sociale në gazetari

Erza Nila

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: erzanila02@gmail.com

Abstrakt

Ky punim shqyrton ndikimin e thellë të mediave sociale në fushën e gazetarisë. Me rritjen e platformave të ndyshme si Twitter, Facebook, Instagram dhe Tik Tok, lajmet shpërndahen në mënyrë të pakontrolluar dhe konsumohen nga publiku. Ky studim shqyrton mundësitë dhe sfidat që media sociale paraqet për gazetarët, duke përfshirë shpejtësinë e shkëmbimit të informacionit, potencialin për gazetarinë qytetare dhe mjegullimin e linjave midis lajmit dhe opinionit. Pika tjetër e këtij punimi është mbi implikimet etike të mediave sociale në gazetari, si verifikimi i burimeve dhe luftimi i dezinformimit. Qëllimi i punimit është që të ofrojë një kuptim gjithëpërfshirës se si mediat sociale kanë riformuar peizazhin e gazetarisë dhe çfarë do të thotë kjo për të ardhmen e informimit apo më saktë, për industrinë e gazetarisë. Punimi konstaton se algoritmi i mediave sociale në shpërndarjen e lajmit është duke arritur audiencë të madhe së asnjëherë më parë në historinë e mediave.

Fjalë kyç: Media sociale, Facebook, Twitter, Instagram, Tik Tok, dezinformim.

Gjuha e urrejtjes në mediat sociale për çështje fetare

Gentrita Xhemajli

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: gentrita2.xhemajli@universitetiaab.com

Abstrakt

Zhvillimi teknologjik ka avancuar hovshëm në dekadat e fundit dhe kjo ka mundësuar që çdo familje të ketë komunikim në mediat sociale dhe internet. Përdorimi i mediave sociale ka ndikuar në zhvillimin e mendimeve ku në shumë herë, ne nuk shohim vetëm mendime pozitive, por edhe negative po shprehje të mllefrit dhe urrejtjes në komunikimet online. Qëllimi i këtij punimi është që të analizojë gjuhën e urrejtjes të përdorur në mediat sociale. Pyetja kërkimore që shtrohet këtu është se sa është e pranishme gjuha e urrejtjes nga personazhet publike në Kosovë, në komunikimet online? Nga cilat media sociale po krijohet më së shumti dhe cilat janë moshat që janë duke shprehur mendimet e tyre negative me anë të gjuhës së urrejtjes në komunikimet online. Nëpërmjet analizimit të debateve televizive, e veçanërisht ato të postuara më pas në mediat sociale, punimi konstaton se diskutimet për fenë janë më të zjarrta dhe ku vërehet një gjuhë e urrejtjes nga debatuesit, gjuhë mosdurimi, fyerje, si ndaj individëve, po ashtu edhe ndaj disa klerikëve fetare. Por, një dozë të gjuhës së mosdurimit shfaqet edhe nga vetë klerikët fetarë kur është fjala për ata që i konsiderojnë si besimtarë jo të devotshëm.

Fjalë kyç: media sociale, gjuha e urrejtjes, mediat, personazhet publike

Roli i medias lokale në ruajtjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve në Mal të Zi

Dafina Teliqi

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: dafi_92@live.com

Abstrakt

Media lokale në gjuhën shqipe në Mal të Zi është e lidhur ngushtë me të drejtat e shqiptarëve në këtë vend dhe identifikohet me problemet e tyre. Politika redaktuese përcaktohet a priori nga qenia e shqiptarëve pakicë kombëtare në këtë vend. Qëllimi i këtij punimi është që të sjellë për publikun jashtë Malit të Zi një analizë për kontekstin specifik në të cilën operon media shqiptare në këtë vend. Në Mal të Zi, në kuader të mediave lokale, në vitin 1998 filloi punën radio “Mir”. Dy vjet më vonë pronari i njëjtë hapi Televizionin “Teuta” në komunën e Ulqinit. Televizioni “Boin” në Tuz u hap në vitin 2001 ku transmeton vetëm në gjuhën shqipe. Në vitin 2002 filloi të botohet e përjavshmja “Koha javore” e cila shpeshherë është përballur me probleme të shumta dhe vështirësi botimi. Metoda e përdorur në këtë punim përfshin analizën historike, identitare dhe atë të përmbajtjes mediatike, të medias lokale shqipe në Mal të Zi, rasti i Televizionit “Teuta”. Rezultatet tregojnë se mediat lokale si mbulim kryesor mediatik kanë problemet që lidhen me çështje identitare, funksionimin e shoqërisë shqiptare dhe vështirësitë e saj brenda shtetit malazez, përdorimi i gjuhës shqipe në administratën publike, arsimi etj. Punimi rekomandon një thellim të përgjithshëm bashkëpunimi ndërmjet Ulqinit dhe Shkodrës, e veçanërisht një bashkëpunim më të thellë me mediat e Shqipërisë.

Fjalë kyç: Media lokale, identitet kombëtar, Tv Teuta, politikë editoriale, Mali i Zi.

Ndërtimi i imazhit të viktimave në mediat shqiptare online

Dr. Ardita Reçi, Shqipëri

arditareci@gmail.com

Dr. Arta Sakja, Shqipëri

artasakja@hotmail.com

Abstrakt

Niveli i kriminalitetit, profesionalizmi i medias dhe niveli i lirisë së shprehjes, janë disa nga treguesit kryesorë të nivelit të demokracisë. Ekzistojnë disa mënyra për t'i studiuar këto elemente në raport me njëri-tjetrin si variabla të ndryshueshëm dhe të pandryshueshëm, një prej të cilave do të përdorim në funksion të këtij referimi. Qëllimi i punimit është të trajtojmë rolin e mediave online (portaleve) në ndërtimin/deformimin e imazhit të viktimave të krimeve, apo viktimizimin me synim përmirësimin e imazhit të personave të caktuar. Në funksion të studimit shtrohet pyetja: me cilat elemente narrative apo vizive ndërtohet imazhi i viktimave në portalet shqiptare? Sa janë këto praktika në nivelin e kërkesave profesionale, etike dhe në përputhje me modelet teorike mbi gazetarinë online? Teorikisht punimi do bazohet në teori dhe studime që lidhen me sociologjinë e gazetarisë. Përgjigjet dhe gjetjet tona do të bazohen në matje konkrete mbi ndjekjen dhe reagimet e publikut në disa prej portaleve kryesore, bazuar në të cilat do të dalim me rekomandime për përmirësimin e situatës së raportimeve online.

Fjalë kyç: media online, portale, viktimizim, gazetar, narrativë, imazh.

Ndikimi i emigrimit online në vlerat konvencionale të komunikimit politik

Hasan Saliu

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: hasan.saliu@aab-edu.net

Abstrakt

Në epokën e platformizimit dhe mediave sociale, shumëçka ka ndryshuar në jetën e njeriut. Kanë ndryshuar komunikimet ndërpersonale, gazetaria, marrëdhëniet publike, komunikimi politik, praktikat e biznesit, por edhe komunikimet e qeverisë me publikun. Ballafaqimi me transformimin dixhital kërkon një reflektim multidisiplinor dhe agjendë kërkimore. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë mënyrat në të cilat revolucioni dixhital ka ndryshuar funksionin konvencional të medias në komunikimin politik në demokraci. Duke përdorur metodën e problematizimit konstatojmë se tani ka shumë lajmëtarë, se të gjithë njerëzit online me një llogari në media sociale janë bërë medium, se miliona partizanë konkurrojnë me aktorë politikë në demokraci dhe e cila çon në censurën online të turmës (Waisbord, 2020, 2023) dhe me mediat sociale laureatët e Nobelit i vendosim në pozita të barabarta me injorantët e zjarrtë. Këto çojnë në përfundimin se njerëzit u përgjigjen më shumë ndjenjave dhe besimeve, sesa fakteve dhe argumenteve dhe se retorika populiste e përhapur nga mediat alternative dhe sociale, ka sjellë demokracinë e facebook-ut (Marichal, 2012) dhe demokracinë e pas së vërtetës (Chambers, 2021).

Fjalë kyç: transformime dixhitale, censurë e turmës, post e vërteta, media sociale.

Shqyrtimi i marrëdhënieve publike strategjike të Qeverisë së Kosovës në Facebook

Vjosa Loshaj Miftari
Kolegji AAB, Prishtinë
Email: vjosa.loshaj@gmail.com

Abstrakt

Mediat sociale po zënë gjithnjë e më shumë hapësirë si mjet komunikimi efektiv për për[imin e mesazheve të institucioneve të sektorit publik në Kosovë. Duke përdorur këto platforma, institucionet publike po tentojnë që të jenë më afër publikëve të tyre, ndryshe prej kanaleve tradicionale të komunikimit të cilat i kanë përdorur më parë. Qëllimi i këtij punimi është që të prezantojë dhe të ekzaminojë strategjitë, menaxhimin dhe shpërndarjen e informative dhe mesazheve në mediat sociale nga Qeveria e Kosovës. Metodologjia e përdorur në këtë punim është ajo e monitorimit dhe analizës së përmbajtjes së postimeve në faqen zyrtare të Qeverisë së Kosovës në Facebook dhe në platformat tjera, përgjatë periudhës janar – maj 2024. Ky punim konkludon se organizatat qeveritare kanë tendencë preference ndaj Facebook-ut krahas të tjerave, për arsye se kjo platformë depërton më së shumti tek audienca më e gjerë, duke qenë se Facebook-u ka më pak limitime në publikimin e përmbajtjes së mesazheve dhe është media sociale më e përdorur në Kosovë.

Fjalë kyç: media sociale, komunikim strategjik, Facebook, Qeveria e Kosovës.

Ndikimi i mediave sociale në marrëdhëniet me publikun

Krenare Hoti

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: krenare2.hoti@universitetiaab.com

Abstrakt

Gjatë dy dekadave të fundit, mediat sociale kanë evoluar nga një formë e panjohur në një mjet komunikimi gjithnjë e më të përdorur për ndërveprim, organizim, apo grumbullim të informacionit. Ky zhvillimi i mediave sociale ka gjeneruar një ndikim në praktikën e marrëdhënieve me publikun pasi që platformat e ndryshme u mundësojnë praktikuesve të marrëdhënieve me publikun dhe palëve të tyre të interesit të komunikojnë në mënyrë interaktive me njëri-tjetrin në kontekste të ndryshme. Si rezultat, qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizoj dhe të paraqesë raportin mes rrjeteve sociale dhe marrëdhënieve me publikun, ndikimin dhe rolin kyç të këtyre mediave në ndërtimin e marrëdhënieve me publikun si dhe aspekte tjera siç janë evulucioni i marrëdhënieve publike në kohën e mediave sociale, si dhe mundësitë dhe sfidat që hasen për marrëdhëniet me publikun. Qasja metodologjike e përdorur në këtë hulumtim është shqyrtim literature i studimeve të deritanishme në këtë aspekt. Gjetjet tregojnë se mediat sociale kanë një rol kyç në PR dhe se ato ndikojnë pozitivisht tek kompanitë të cilat përçojnë mesazhin tek audienca më të mëdha dhe në kohë shumë më të shpejtë duke rezultuar në një PR të integruar.

Fjalë kyç: media sociale, marrëdhënie publike, PR i integruar

Katalogim në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjeteër Bogdani"

004.3:659(062)


Book of abstracts : international Conference on Media and Communication : information, Media and Truth in the Post-Truth and Artificial Intelligence Era / organized by AAB College. - Prishtinë : Kolegji AAB, 2024. - 57 f. ; 26 cm.

Teksti paralel në gjuhën angleze dhe shqipe

ISBN 978-9951-832-24-3



ISBN 978-9951-832-24-3



9 789951 832243